Policia parandalon krimin në Durrës/ Arrestohet 40-vjeçari, me automatik në krah kërkonte bashkëshorten që kishte ikur nga shtëpia me gjithë fëmijët pasi ishte dhunuar (EMRI)

20 Maj, 2023 10:52



Madhësia e tekstit:

Një 40-vjeçar është arrestuar paraditen e sotme në Durrës, pasi është kapur me armë zjarri dhe municion luftarak.

Sipas policisë 40-vjeçari ishte në kërkim të bashkëshortes së tij, e cila ishte larguar nga shtëpia bashkë me fëmijët, për shkak të dhunës. Sakaq mësohet se bashkëshortja kishte denoncuar rastin dhe kishte marrë një urdhër mbrojtje.

Në pranga ka rënë Lulëzim Haxhiu, 40 vjeç, banues në fshatin Shkallnur, Durrës.

Shërbimet e Policisë, gjatë kontrollit në automjetin me të cilin qarkullonte ky shtetas, gjetën dhe sekuestruan një armë zjarri tip automatik PMSH me karikator me municion luftarak.

Nga veprimet hetimore rezultoi se ky shtetas ishte larguar prej disa ditësh nga banesa, sepse bashkëshortja e tij është e pajisur me urdhër mbrojtjeje nga Gjykata e Durrësit, që prej datës 04.05.2023, për shkak të dhunës së ushtruar nga ky shtetas.

Dyshohet se 40-vjeçari po kërkonte bashkëshorten për ta vrarë, e cila ishte larguar nga banesa, së bashku me fëmijët. Ndërhyrja në kohë e Policisë për kapjen e tij parandaloi ngjarjen e rëndë kriminale.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për veprime të mëtejshme.

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

Etiketa: arme zjarri | Durres

TË NGJASHME

U ekzekutua me një plumb në kokë/ Arian Gosa ishte me babanë në një lokal në Kavajë, autori pas vrasjes u largua në këmbë FOTO+VIDEO
21 Maj, 2023

Atentati në Kavajë, policia njoftim zyrtar: Janë ngritur pika kontrolli. Shkak i vrasjes, hakmarrja
21 Maj, 2023

Taboola Feed

If you own a mouse, you will never turn off your computer again.
No Install. Play for free.
Combat Siege | Sponsored
Play Now

If you have nail fungus, do this immediately
Lotbuse | Sponsored
Get Offer

Zbulohet vlera marramendëse e pasurisë së Devi Kasmit që u sekuestrua nga Prokuroria, kishte bandë kokaine me bazë në Milano
Zbulohet vlera marramendëse e pasurisë së Devi Kasmit që u sekuestrua nga Prokuroria, kishte bandë kokaine me bazë në Milano
balkanweb.com

Currently the best free game. No Install. Play for free.
RiverCombat | Sponsored

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

Humbi jetën në një burg në Zvicër/ IML nuk zbulon shkaqet e vdekjes se Briken Hoxhës, mjekoligjorët: S'konstatohen thyerje të kockave
Klodiana Lala | 21 Maj, 2023

U ekzekutua në sy të babait në Kavajë/ Si Arian Gosa dhe vëllai i tij masakruan me thikë Gentian Gjuzin në 2012 (Detaje nga dosja)
21 Maj, 2023

Dinamika e vrasjeve në Kavajë/ I vëllai u ekzekutua sot duke pirë kafe, si mbeti i vrarë Edmond Gosa pas sherrit me Altin Rexhën (VIDEO)
21 Maj, 2023

Hakmarrja pista kryesore/ Ekzekutohet me një plumb në kokë vëllai i Edmond Gosës, kontrolle në disa banesa, merren në pyetje dëshmitarët
21 Maj, 2023

U qëllua për vdekje në një lokal në Kavajë, zbulohet identiteti i viktimës, pista kryesore ku po heton policia
21 Maj, 2023

Atentati në Kavajë, Arian Gosa qëllohet për vdekje në një lokal, dalin pamjet e para nga vendi i ngjarjes (VIDEO)
21 Maj, 2023

KATEGORIA VIDEO

Dinamika e vrasjeve në Kavajë/ I vëllai u ekzekutua sot duke pirë kafe, si mbeti i vrarë Edmond Gosa pas sherrit me Altin Rexhën (VIDEO)
21 Maj, 2023

VIDEO/ Napoli dhuron spektakël, Interi pëson disfatë, gara për Champions e hapur
21 Maj, 2023

Hakmarrja pista kryesore/ Ekzekutohet me një plumb në kokë vëllai i Edmond Gosës, kontrolle në disa banesa, merren në pyetje dëshmitarët
21 Maj, 2023

VIDEO/ Titulli një fitore larg, Dortmund lëkundon Augsburg, dopietë Haller
21 Maj, 2023

U ekzekutua me një plumb në kokë/ Arian Gosa ishte me babanë në një lokal në Kavajë, autori pas vrasjes u largua në këmbë FOTO+VIDEO
21 Maj, 2023

Atentati në Kavajë, policia njoftim zyrtar: Janë ngritur pika kontrolli. Shkak i vrasjes, hakmarrja
21 Maj, 2023

App Store | Google Play

Kërko këtu

LAJMET E FUNDIT

Humbi jetën në një burg në Zvicër/ IML nuk zbulon shkaqet e vdekjes se Briken Hoxhës, mjekoligjorët: S'konstatohen thyerje të kockave
Klodiana Lala | 21 Maj, 2023

Vojsava Alia rrëfen në "Dola te Ola" historinë e dashurisë me kompozitorin Vani Rushiti
21 Maj, 2023

U ekzekutua në sy të babait në Kavajë/ Si Arian Gosa dhe vëllai i tij masakruan me thikë Gentian Gjuzin në 2012 (Detaje nga dosja)
21 Maj, 2023

City favorit në Champions, Rummenigge mendon ndryshe: Interi mund të lëndojë
21 Maj, 2023

Analiza/ Sigla e "BF" merr gjysmën e votave të kandidatëve për kryebashkiakë. Si ndahen këshilltarët brenda koalicionit opozitar
Maj, 2025

Dinamika e vrasjeve në Kavajë/ I vëllai u ekzekutua sot duke pirë kafe, si mbeti i vrarë Edmond Gosa pas sherrit me Altin Rexhën (VIDEO)
Maj, 2025

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb

© 2023 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.